



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI BASHKISË PATOS

Nr. 2016/2 Prot.

Patos më, 02/07/2026

VENDIM

Nr. 33, datë 29.06.2026

**MBI MIRATIMIN E PROJEKT DOKUMENTIT TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM FAZA E PARË 2027-2029.**

Në zbatim të shkronjës “dh” të nenit nr. 54, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, të nenit nr. 36, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit nr. 36, të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, udhëzimit nr. 07, datë 27.02.2026 i Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e buxhetit afatmesëm vendor” VKB nr. 14, datë 25.02.2026 “Për vlerësimin, parashkrimin afatmesëm të të ardhurave të bashkisë Patos për vitet 2027-2029”, VKB nr. 18, datë 31.03.2026 “Për miratimin e tavanëve përgatitor të PBA 2027-2029”, udhëzimit të brendshëm nr. 01 datë 14.04.2026 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029”, Këshilli i Bashkisë i mbledhur më datë 29.06.2026 pasi analizoi projektvendimin e paraqitur nga ekzekutivi:

VENDOSI

1. Të miratojë projekt dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 , faza e parë.
2. Pjesë e vendimit është projekt dokumenti i PBA-së 2027-2029, faza e parë dhe raportet PBA 1 – 9, të përgatitura sipas sistemit të menaxhimit buxhetor (smbv.fvv.al) dhe shtojcave të udhëzimit nr. 7, datë 27.02.2026.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi
4. Ky vendim u shpall në datën 02.07.2026.
5. Vendimi hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.



KRYETAR
Armand Ahmetaj